

RILINDASI

Viti III - Nr:25

E diel, 23 qershor 2013

Kryeredaktore: Admirina PEÇI

Na ndiqni edhe online

WWW.SHQIPTARJA.COM

SYRJA BEJ VLORA

Një portret i rrallë për Ismail Qemalin

A ishte dëshmitar i atmosferës së shpalljes së Pavarësisë, i përpjekjeve dhe planeve për të mbërritur tek ajo ditë, i njëjti nga afër personazhet e ngjarjes me të madhe të historisë së shqiptarëve. Me disa ndante njëjtat mendime e ideale, me të tjerë ishte kundërshtar, e ndonjë prej tyre e kritikonte deri në mohim. Syrja bej Vlora nuk ishte një personazh i zakonshëm. Pinjulli i familjes së njohur të Vlorajve, që i kishte dhënë Perandorisë Osmane, pashallarë e vezirë, i biri i Mustafa Pashë Vlorës dhe vëllai i Vezirit të Madh, Ferit Pashë Vlorës (1903-1908), kushëri i Ismail Qemalit, por njëherësh rival i tij politik, babai i Eqrem Bej Vlorës, kujtimet e të cilit u botuan me bujë disa vite më parë, kuanat i Esat Pashë Toptanit, të cilit i kishte marrë motrën për grua, drej-



NË FOTO: (Majtas) Syrja Bej Vlora (Djathas) Ismail Qemali



Ismail Qemal Beu, ai mendoi vetëm për dëshirat vetjake

Në personalitetin e Ismail Qemal Beut, në sjelljen e tij kishte seriozitet dhe fisnikëri. Për kërkesat ndaj vetes së tij të detyronte ta nderoje. Tregonte shumë kujdes të kishte nën kon-

troll dhe të kujtonte secilin. Në çdo situatë shihej si kryetar dhe mund ta ruante vazhdimisht ekuilibrin. Rugën e jetës së tij e kaloi me shumë probleme, por nuk tregoi dobësi. Nuk ishte i lumtur, por nuk

e tregonte veten të pashpresë dhe të mërzitur. Të ardhurat i shpenzonte në vende të panevojshme. Në këtë periudhë gjithmonë gjendej në vështirësi të tmerrshme. Por i pëlqente ...

tor i përgjithshëm i doganave osmane, deputet në Parlamentin Osman pas vitit 1908, ambasador i Shqipërisë në Vjenë më 1914, njeri i arsimuar mirë për kohën, personi në shtëpinë e të cilit, në lagjen Taksim në Stamboll, në janarin e vitit 1912 u bë mbledhja e njohur (morën pjesë Ismail Qemali, Hasan Bej Prishtina, Myfit Bej Libohova, Esat Pashë Toptani etj....) dhe u mor vendimi për të shpërbërur në Shqipëri një kryengritje e përgjithshme antiosmane, i preferuari i Vjenës në vjeshtën e vitit 1912 për të organizuar e drejtuar procesin e pavarësisimit të Shqipërisë, pronar i madh, një nga personat që do të fusnin elementë të drejtimit kapitalist në pronat e tij agrare në vitet 20-30 etj. etj. Pikërisht ky person me emër në elitën politike e atë ekonomike të kohës, dinte shumë, kishte njohur shumë, kishte qenë...

faqe 15

vijon në faqen 14-15

Rexhep Qosja: Në letrat shqipe mungon historia e përkthimit

Akademik Qosja analizon ndikimin që ka përkthimi i letërsisë botërore në letërsinë shqipe përmes historikritimit të përkthyesve që nga periudha e Letërsisë së vjetër, Rilindjes dhe shekullit XX

REXHEP QOSJA

Ka një gjysmë shekulli që kur historianë të letërsisë europiane ankoreshin se në asnjërin nga letërsitë kombëtare në Evropë nuk kishte "punime fundamentale nga historia e përkthimeve, megjithëse pa trajtimin historiko-letrar të këtij tipi ende të pastuduar të krijimtarisë letrare, historia e letërsisë mbetet e mangët".

Çka mund të themi në për këtë çështje? Mund të themi se gjysmë shekulli pas botimit të veprës në të cilën është theksuar mendimi i cituar, ne nuk kemi fare teori të përkthimeve, kemi fare pak trajtesa, studime a

monografi për përkthimet e mëhershme dhe pothuajse aspak vështrime ditore për përkthimet e shumta që bëhen sot! Për një histori të përkthimeve në gjuhën shqipe as nuk është bërë fjalë ndonjëherë, as nuk bëhet fjalë sot. E historia e përkthimeve është një shkencë shumë e rëndësishme dhe është shumë e rëndësishme për dy arsye: e para, është e rëndësishme për studimin e gjuhës në të cilën bëhen përkthimet, për studimin e historisë së saj, të zhvillimit të saj, të pasurimit të saj me fjalë e me trajta morfologjike të reja dhe, e dyta, është e rëndësishme për studimin e letërsisë kombëtare, të procesit të zhvillimit të saj, të rrymave dhe drejtimeve të saj...

faqe 18-19



pjeter logoreci

Destan Gashi, guri i çmueshëm i Kosovës

Profili i një skulptori kosovar në Vjenë... nga ditët e fëmijërisë në Ziqisht të Rahovecit, ku krijonte figurina të mrekullueshme me balte deri tek ekspozitat, vlerësimet dhe përhapja e veprave të tij në të gjithë botën

NGA PJETER LOGORECI

faqe 20-21

Emigrimi i arbëreshve të San Paolos për në Amerikë

Historia e Giacinto Blumetti, lindur në Sao Paolo Albanese në vitin 1930, i cili tregon se si u arsimua dhe perpjekjet për të mësuar zanatin e rrobaqepësit e mandej emigrimin drejt Amerikës...

ROSA BUCCOLO

Në vitin 1861 Italia gjendej akoma në kushte ekonomike, politike dhe sanitare shumë të këqija. Kjo është ajo që tregohet në komunën e vogël San Paolo Albanese që në atë vit jetonin 1430 banorë dhe në dekadën në vijim ka pasur një rënie prej 7.7% të popullsisë për shkak të emigrimit dhe epidemisë së kolerës. Më pas shifra ulet deri në 23.2% në 1901 për shkak të epidemisë së fundit të lisë në 1870-71, duke prekur komunën e San Paolo Albanese që ccoi në numrin e banorëve në 836. Në dekadat vijuese shënohet një tjetër rënie të lartë e popullsisë ku në

vitet 1961-1971, popullsia shënoi një rënie prej 21%.

Këtë herë shkaku ka qenë emigrimi në Gjermani, Francë, Zvicër dhe SHBA. Një fat që bashkoi shumë prej banorëve të San Paolos ku me kalimin e viteve u rikthyen në vendin e tyre duke bërë të mundur që ne të bëhemi të vetdijshëm për përvojën e tyre të emigrantit. Një histori e tillë i takon z Giacinto Blumetti, lindur në Sao Paolo Albanese në vitin 1930, i cili tregon se u arsimua deri në moshën 14 vjeç, dhe për arsye të vështirësive ekonomike, ai u detyrua të gjente një punë. Zgjedhja mes dy zanateve më të popullarizuara në atë kohë ishte muratori apo rrobaqepsi...

faqe 22

KUJTIME | PERSONAZHI

SYRJA BEJ VLORA:


Kujtime për pavarësinë, flamurin dhe kuvendin e Vlorës

vijon nga faqja 13

...i pranishëm në shumë ngjarje...

Ndaj kujtimet e tij kanë një vlerë të veçantë. Shkruar në osmanisht në vitet '20, me gjasë në 1921-1925 në Romë dhe në Vlorë ku jetoi në ato vite, përkthyer në gjysmën e dytë të viteve '40, përkthim i gjetur në arkivin e Institutit të Historisë me inicialet A.A (mbase Ali Asllani), me një redaktim shkencor dhe i përgatitur për botim nga Akad. asoc. Marenglen Veri dhe dr. Ledia Dushku, këto kujtime të vyera vijnë më në fund në dorën e lexuesve shqiptarë. Siç mësohet nga botuesi, libri i shumëpritur me kujtimet e Syrja bej Vlorës me titullin "Historia e Shqipërisë nga invadimi osman më 1400 deri në Luftën e Vlorës dhe çlirimin e saj nga okupacioni italian më 1920" del nesër në qarkullim.

Dy pjesë mjaft ngacmuese kemi përzgjedhur këtë herë për lexuesit tanë, mbi ngjarjet që i paraptrinë shpalljes së Pavarësisë dhe pas saj si dhe një portretizim të rrallë që i bëhet plakut të Vlorës nga Syrja bej Vlorë, kundërshtari më i fortë politik i tij.



Ismail Beu

Por, njëzet ditë para se të vinte [në Vlorë] Ismail Beu, nën komandën e [Spiro] Spiromilos, në Himarë kishin dalë dy batalione hajdutësh, të cilët quheshin xhandarë gjirtas (kretas), të cilët populli i kishte pritur mirë. Me përhapjen e këtij lajmi populli i Vlorës u shqetësua



(kretas), të cilët populli i kishte pritur mirë. Me përhapjen e këtij lajmi populli i Vlorës u shqetësua. Situata ishte shumë e trazuar, Paria u mbledh në zyrën qeveritare të vendit. Për të ndaluar zgjerimin dhe shkeljen e vendeve të tjera nga hajdutët, Eqremi u ngarkua që të nisej me fuqinë, të cilën ai vetë do të mund të mblidhte. Eqremi shkoi në Velçë dhe në Smokthinë ku qëndroi dy ditë në çdo vend dhe mblodhi me qindra njerëz. Ditën që arriti në Kuç i erdhën 200 vetë nga populli i Kurveleshit, si edhe rreth 200 xhandarë, të cilët u dërguan nga Gjirokastra nën komandën e një majori. Fuqia e armikut, e cila u forcua duke u bashkuar me elementin e krishterë të vendit, shkaktoi shqetësim. Megjithatë, përballë guximit dhe trimërisë që treguan ushtarët e mbledhur, ajo nuk mundi të bënte çap jashtë kufirit të Himarës. U bënë disa përplasje dhe të dy palët ruajtën pozitat që kishin zënë (97). Në këtë kohë, Eqremi i vjen një letër nga Ismail Qemal Beu. Në këtë letër, e cila botohet tekstualisht më poshtë (98), deklarohet se qeveria provizore e formuar në Vlorë, duke pritur vendimin e Konferencës [së Ambasadorëve] që ishte mbledhur në Londër, ruhej nga të hyrit në armiqësi me shtetet e Ballkanit, prandaj ushtarët dhe vullnetarët duhej të qëndronin në pozite mbrojtëse.

Mirëpo, siç u shpreh edhe vetë Ismail Qemal Beu, ishte shumë e vështirë që të mbaheshin në një pozite mbrojtëse më tepër se 1.000 vullnetarë. Aq më tepër që këta, duke keqkuptuar rekomandimet e katër vetëve, të cilët erdhën në qëndrën ushtarake si të dërguar

dhe të ngarkuar nga Vlorë për të këshilluar Eqremin që verbalisht të vepronte me ngadalësi, u shpërndanë. Pra fuqia e mbledhur u shpërndanë dhe mbeti vetëm një fuqi sa të mund të mbronë disa vende të ashpra. Ishulli i Sazanit, që ndodhet në hyrje të limanit të Vlorës, ishte okupuar prej grekëve që në fillim të luftës dhe rreth e përqark tij vinin vërdallë anijet greke. Kështu të krishterët, të cilët kishin lidhur shpresën të helenizmi, ndizeshin çdo ditë e më shumë. Këto anije disa herë hynë në limanin e Vlorës dhe qëlluan me top zyrat që ndodheshin në skelë, si edhe qytetin. Sado që këto të shtëna nuk bënë ndonjë dëm, ato shkaktonin turbullimin e popullsisë. Një ditë kur këto anije hynë në liman për të përsëritur mësymjen, Ismail Beu dërgoi me flamur të bardhë në dorë, pranë komandantit të anijëve, ministrin Gurakuqi dhe nga paria Sami Bej Vriionin. Me anën e tyre, ai i njoftoi komandantit se Vlorë është kryeqyteti i Mbretërisë Shqiptare, që shpall pavarësinë e saj dhe nuk ndodhet në luftë me Mbretëritë Ballkanike. Flamurin që ngriti, duke e ringjallur pas pesëqind vjet robërie, në vend që ta përshëndetnin, ishte për t'u çuditur e qeardhur, që e qëllonin me top. Komandanti i anijëve, i prit mirë zotin Gurakuqi dhe Sami Beun. I deklaroi se çka ata i thanë, do t'ia njoftonte qeverisë së tij dhe do të vepronte sipas urdhrave të reja që

SYRJA VLORË

Berati iu dha urdhër nga Janina për të kapur dhe arrestuar Ismail Qemalin, i cili udhëtonte nga Durrësi në Kavajë e mandej për në Vlorë. Për të zbatuar urdhrin ishte dërguar një kompani ushtarake, por Ismail Qemali pa ndeshur në ta dhe pa pësuar gjë, ishte futur në Vlorë me gjithë shokët që e shoqëronin. Aty gjeti gati gjithë parinë të ardhur nga çdo vend, të cilën unë e kisha ftuar për të ardhur, pa marrë parasysh mijëra ushtarë osmanë që ndodheshin në Fier e në Berat. Më 28 nëntor, me dëshirën dhe pëlqimin e të gjithëve, u vendos të ngriej flamuri i Shqipërisë dhe të shpallet Pavarësia Kombëtare.

Pasi atë ditë nuk kishte mundësi të përgatitej flamuri, u mor nga shtëpia jonë një flamur, që djali im Eqremi (96) që nga viti 1908 e ruante me plot nderime. Ai u ngrit në mes të manifestimeve e

brohoritjeve gazmore të popullit dhe atë çast u formua një qeveri si më poshtë:

Kryetar i qeverisë dhe ministër i Punëve të Jashtme - Ismail Qemal Beu;

Nënkryetar i qeverisë - Imzot Dom [Nikollë] Kaçorri nga Durrësi; Ministër i Brendshëm - Myfit Beu nga Libohova;

Ministër i Post-Telegrafëve - Lef Nosi nga Elbasani;

Ministër i Financave - Abdi Bej Toptani nga Tirana;

Ministër i Drejtësisë - zoti Petro Poga nga Gjirokastra;

Ministër i Arsimit - zoti Luigj Gurakuqi nga Shkodra;

Ministër i Bujqësisë - zoti Pandeli Cale nga Korça;

Ministër i Botores - Mit'hat Beu nga Frashëri;

Ministër i Luftës - Mehmet Pashë Deralla nga Kalkandeleni.

Gjithashtu u formua një senat me atributet e një Këshilli Shteti prej 18 vetësh dhe kryetar u zgjodh myftiu i Dibrës, Vehbi Efendiu,

Fuqia e armikut, e cila u forcua duke u bashkuar me elementin e krishterë të vendit, shkaktoi shqetësim. Megjithatë, përballë guximit dhe trimërisë që treguan ushtarët e mbledhur, ajo nuk mundi të bënte çap jashtë kufirit të Himarës

kurse nënkryetar Eqrem Bej Vlorë.

Por, njëzet ditë para se të vinte [në Vlorë] Ismail Beu, nën komandën e [Spiro] Spiromilos, në Himarë kishin dalë dy batalione hajdutësh, të cilët quheshin xhandarë gjirtas



NË FOTO:
Syrja Bej Vlora

ISMAIL QEMAL BEU

Ai mendoi vetëm për dëshirat vetjake

SYRJA VLORA

Në personalitetin e Ismail Qemal Beut, në sjelljen e tij kishte seriozitet dhe fisnikëri. Për kërkesat ndaj vetes së tij të detyronte ta nderojë. Tregonte shumë kujdes të kishte nën kontroll dhe të kujtonte secilin. Në çdo situatë shihej si kryetar dhe mund ta ruante vazhdimisht ekuilibrin. Rrugën e jetës së tij e kaloi me shumë probleme, por nuk tregoi dobësi. Nuk ishte i lumtur, por nuk e tregonte veten të pashpresë dhe të mërzitur. Të ardhurat i shpenzonte në vende të panevojshme. Në këtë periudhë gjithmonë gjendej në vështirësi të tmerrshme. Por i pëlqente vetja dhe dashuritë kalimtare. Fuqinë e mendjes e kishte të përkryer, por kishte të metë se kishte aftësi të mashtronte me fjalë. Kur kërkonte të zotëronte situatën, vendoste autoritetin, bëhej tahmaqar dhe i shkante fjala: kundërshtonte, thërriste, por qëndronte larg nga zënitët dhe konfliktet.

Nuk e prishte qetësinë nëse nuk ishte i detyruar; nuk kërkonte të ngatërrohej me fjalë; ishte i pasur në ndjenjat e tij; ishte i ditur dhe nuk i shikonte gjërat në mënyrë sipërfaqësore. Rrallë kalonte në situata të padëshirueshme. Me asnjë nuk zuri marrëdhënie miqësore. Në marrëdhëniet përballë dy personave gjatë bisedës donte të tregonte epërsinë e tij. Dukej se i donte Atdheun dhe patriotët. Pas fitores së serbëve dhe bullgarëve u largua nga Stambolli për në Vjenë. Duke qenë i sigurt në ndihmën e Austrisë prej andej u drejtua për në Vlorë. Nga Shqipëria iku i vogël dhe u kthye në moshë të pjekur. Prej fëmijërisë në mendjen e tij kishte krijuar një imazh tjetër për Shqipërinë. Ndryshimet e mëdha që vuri re me kthimin në Shqipëri, e bënë atë të vendoste të prishte imazhin e krijuar në mendje, të merrej me politikë e të punonte sa të kishte fuqi.

Mund të themi se rrethi shoqëror që gjeti ishte më i përparuar. Në ballafaqim me secilin shpjegonte elementin (e administrimit publik) "kanton" dhe të mirat e tij. Mirëpo bashkimi i pronës nuk siguronte mbështetje në formë të prerë. I kishin tërhequr vëmendjen se forma e ndarjes së shtetit në kantone do të kërkonte ndarje administrative. Ai e dinte sa e rrezikshme dhe sa shumë e nevojshme ishte të merrej ende në vëmendje pjesa e punës së policit, pasi ende brenda nesh administrimit i shoqërive (komuniteteve që i bashkonin zakonet dhe traditat), nuk kishte arritur nivelin e duhur. Prandaj kërkimet dhe



Ismail Qemali

vëzhgimet ishin tepër të nevojshme. Qeveria në vite ishte civilizuar. Përparimi, civilizimi dhe bashkimi në një vend konsiderohej dhe pranohej si i shenjtë. Por, gjuha dhe civilizimi nuk ishin pranuar në popull. Kjo nuk do të ishte e mundur të përvetësohej nga secili menjëherë.

Mund të themi se Ismail Beu me këtë zhvillim të inteligjencës, i parapriu Esat Pashës. Në emër të "Shqipëria me dy qeveri" Esat Pasha mori guximin të kalonte situatën dhe të formonte qeverinë e dytë, duke hapur kështu një derë të shkatërruar. Sidoqoftë Ismail Qemal Beu nuk pati frikë dhe e kuptoi nevojën e vendit tonë që programet politike të lëvizjes duhet të bashkoheshin dhe të merreshin masa të cilat

do t'i shërbenin shoqërisë sonë. Por ligjet e vëna nuk e garantonin këtë. Ismail Qemal Beu ishte një nga ata që e njihte më mirë Kushtetutën Osmane. Që prej kohës së Mit'hat Pashës ai e kishte treguar këtë me zgjuarsinë e të kuptuarit të situatave. Vendi ushqente shpresa të mëdha. Rreth 14-15 muaj që ishte në drejtim e kaloi gjithë kohën në udhëtim. Ai ishte një udhëheqës që nuk pati një vdekje të lumtur. Si kryetar asnjëherë nuk përfitoi nga posti që kishte.

Në një situatë ku ai lehtësoi realizimin e qëllimit të udhëtarëve, që lëviznin nga Stambolli me vaporin "Meran", me dhënien e njoftimit se rrezikonin të shkaktonin gjendje kaotike në Shqipëri, u bë objekt i marrjes së fajit.

Nëse duhet të analizojmë personalitetin e tij mund të them se Ismail Qemal Beu asnjëherë nuk ndoqi një qëllim serioz në politikë. Profesioniin e tij, politikën, mikun dhe familjen e tij nuk i mendoi më tepër se veten. Mendoi vetëm për veten e tij. Vazhdimisht jetoi në luftë dhe kënaqësinë më të madhe të jetës e gjeti në sigurimin e dëshirave vetjake. Më së fundi them se Shpallja e Pavarësisë nga Ismail Qemal Beu është shërbimi për të çuar në vend detyrën. Fitorja e saj ishte e drejtë për historinë e kombit tonë dhe e rregullt. Mëshira e Zotit qoftë mbi të!

Përgatitja dhe redaktimi shkencor: Akad. Asoc. Marenglen Verli dhe Dr.Ledia Dushku

do të merrte. Anijet në fjalë, nuk erdhën më të përsëritnin mësymjen dhe nga kjo kuptohej se qeveria greke do t'u kishte dhënë urdhër të mos qëllonin më në Vlorë. Ndoshta ajo u druajt edhe nga Italia dhe kështu e ndryshoi sjelljen e saj.

Ushtarët shqiptarë që ndodheshin në vende të fortifikuara në Janinë, arratiseshin aq shumë sa ishte për të ardhur keq. Qeveria [e Vlorës] nën shtytjen morale të njerëzve me mend dhe patriotë, nga drejtimi i Përmetit e Gjirokastrës nisi për në Janinë ministrin Mit'hat Bej Frashërin, me detyrë që të këshillonte ushtarët. Por ai nuk pati sukses t'i bindte, as ata që ishin arratisur që të ktheheshin, as ata që kishin mbetur, të mbanin vendet ku ishin. Qeveria provizore për shpëtimin e Janinës, jo vetëm që nuk e dha ndihmën e saj të plotë, por siç dihet edhe, vetë Ismail Qemali, për këtë çështje nuk u përpoq dhe nuk insistoi.

Një pjesë e të arratisurve, për shembull ata që ishin nga Çamëria, u ngjiten pas familjeve të tyre, që ishin sulmuar nga banditë grekë e rumë. Pjesa tjetër e kishin humbur shpresën se lufta do të fitohej dhe kishte lidhur shpresën me Shqipërinë e re, të sotmen dhe të ardhmen e së cilës populli e shihte të sigurt. Veç kësaj, ishin shumë të varur nga shtetërit që vinin nga Vlorë. Sipas mendimit të ushtrisë [osmanë] dhe të parisë, këto arratisje medoemos u shkaktuan nga nxitjet e Vlorës.

VEPRAT | KRITIKA

REXHEP QOSJA

REXHEP QOSJA

Në letrat shqipe mungon historia e përkthimit

Përkthimi luan rol në zhvillimin historik të letërsisë Shqipe. Sot përkthime të dobëta, mungon teoria e përkthimit

Ka një gjysmë shekulli që kur historianë të letërsisë evropiane ankoheshin se në asnjërin nga letërsitë kombëtare në Evropë nuk kishte "punime fundamentale nga historia e përkthimeve, megjithëse pa trajtimin historiko-letrar të këtij tipi ende të pastudiuar të krijimtarisë letrare, historia e letërsisë mbetet e mangët".

CKA MUND TË THEMË NE PËR KËTË ÇËSHTJE?

Mund të themi se gjysmë shekulli pas botimit të veprës në të cilën është theksuar mendimi i citalur, ne nuk kemi fare teori të përkthimeve, kemi fare pak trajtesa, studime a monografi për përkthimet e mëhershme dhe pothuajse aspak vështrime ditore për përkthimet e shumta që bëhen sot! Për një histori të përkthimeve në gjuhën shqipe as nuk është bërë fjalë ndonjëherë, as nuk bëhet fjalë sot. E historia e përkthimeve është një shkencë shumë e rëndësishme dhe është shumë e rëndësishme për dy arsye: e para, është e rëndësishme për studimin e gjuhës në të cilën bëhen përkthimet, për studimin e historisë së saj, të zhvillimit të saj, të pasurimit të saj me fjalë e me trajta morfologjike të reja dhe, e dyta, është e rëndësishme për studimin e letërsisë kombëtare, të procesit të zhvillimit të saj, të rrymave dhe drejtimeve të saj, të stileve dhe teknikave të saj krijuese. Përkthimet, si e thonë historianë të tyre, herët më të shpeshta janë faktor i evolucionit në letërsinë dhe në kulturën në të cilën bëhen. "Nga aspekti i çdo letërsie të veçantë kombëtare të shikuara, përkthimet janë faktorë që sjellin llojlloshmëri më të madhe; përkthimet sjellin në stilet dhe në mënyrën e mendimit të letërsisë e të kulturës në të cilën bëhen impulse që vijnë, ta themi, prej Hemingueit, Foknerit ose Joneskos dhe kështu i kontribuojnë diferencimit të brendshëm të letërsisë kombëtare.

Arsyet pse nuk kemi as teori të përkthimeve, as histori të përkthimeve dhe pse studimet e përkthimeve në gjuhën tonë janë të pakta e të vona, pa dyshim, janë të ndryshme, por arsyeja kryesore është kjo: deri në Luftën e Dytë Botërore është jashtëzakonisht i vogël numri i përkthimeve në gjuhën shqipe. Për këtë arsye kur flitet për rolin e përkthimeve në procesin e zhvillimit historik të letërsisë shqipe deri në Luftën e Dytë Botërore duhet të njihen, jo vetëm ato pak përkthime që janë bërë, por njëkohësisht duhet të dihen edhe emrat e shkrimtarëve të huaj, që shkrimtarët tanë kanë lexuar, kanë cituar apo vetëm kanë përmendur në krijimtarinë e tyre. Leximi i letërsive të mëdha evropiane në gjuhë në të cilat janë krijuar ato luan rolin që në krijimtarinë e tyre do të luanin përkthimet.


LETËRSIA E VJETËR DHE PËRKTHIMET

Siç dihet, që nga dokumentet e para të shkrimit të gjuhës shqipe e deri te epoka e Rilindjes Kombëtare, domethënë për më tepër se katër shekuj kemi fare pak përkthime në gjuhën shqipe. Dhe, ato janë përkthime të librave fetare të bëra për nevojat fetare, kryesisht nën ndikimin apo me kërkesën e institucioneve fetare të Reformacionit në Vatikan. Disa prej këtyre përkthimeve, sidomos ato që janë bërë prej autorësh me prirje letrare, sikundër ishin, fjala vjen, Pjetër Budi dhe Pjetër Bogdani, Muhamet Kycyku dhe Dalip Frashëri, nuk janë pa vlerë, disa më të paktë e disa më të dukshme letrare. Por, megjithatë, nuk mund të thuhet se këto përkthime kanë luajtur ndonjë rol në zhvillimin historik të

letërsisë shqipe, as që kanë frymëzuar rryma e drejtime, as që e kanë shpejtuar procesin e zhvillimit historik, as që e kanë çuar në drejtim të letërsisë evropiane letërsinë shqipe. Ato ishin përkthime, mbi të gjitha, me rëndësi historike shkrimore në kulturën e popullit shqiptar.

LETËRSIA E RILINDJES KOMBËTARE DHE PËRKTHIMET

Edhe në epokën e Rilindjes Kombëtare,



Rexhep Qosja


sidomos në etapën e saj të parë, deri te Lidhja Shqiptare e Prizrenit, vazhdon përkthimi i librave fetare në gjuhën shqipe, por, tani, në radhë të parë përkthimi i librave të shenjtë: i

Biblës dhe i Kur'anit.

Vetëm nga fundi i epokës së Rilindjes, në gazetën dhe revistat e pakta në gjuhën shqipe dhe në përmbledhjet e rilindësve botohen disa përkthime a përshtatje vjershsh, fabulash dhe prozash, kryesisht nga letërsia antike greke e romake, letërsia italiane dhe letërsia franceze. Botimi i ndonjë përkthimi si libër është tejet i rrallë. Veprimtaria përkthimore si një veprimtari e organizuar dhe e përhershme, edhe në epokën e Rilindjes Kombëtare, mbetet institucion kulturor i panjohur në letërsinë shqipe.

Si atëherë mund të flasim për rolin e letërsisë evropiane në procesin e zhvillimit të letërsisë shqipe? Si mund të flasim për rolin e përkthimeve në letërsinë e Rilindjes sonë Kombëtare?

Shkrimtarët e Rilindjes sonë Kombëtare kanë ditur me shumë gjuhë të huaja. Dhe, kanë ditur gjuhë të huaja qoftë pse numri më i madh i tyre kanë jetuar jashtë atdheut – në kolonitë shqiptare në Itali, në Stamboll, në Bukuresht, në Kairo, në Sofje, në Belanik, qoftë pse të gjithë ata janë shkolluar në gjuhë të huaja. Njohja e gjuhëve të huaja, para së gjithash, e italishtes, e frëngjishtes, prej disave nga ata edhe e gjermanishtes a anglishtes, do t'u bëjë të mundshme atyre t'i lexojnë letërsitë e mëdha kombëtare evropiane dhe, ashtu, të mos e ndjejnë mungesën e përkthimeve. Shkrimtarët që kanë çmuar më së shumti ata, prandaj, edhe i kanë cituar apo vetëm përmendur në shkrimet e tyre të ndryshme – në poezi, në prozë, në shkrime kritike e në publicistikë, janë: Homeri, Sapfo, Anakreonti, Pindari, Plauti, Lukreci, Katuli, Virgjili, Horaci, Tibuli, Ovidi, Lukani, Juvenali, Taciti, Plutarku, Dante, Petrarca, Ariosto, Shekspiri, La Fonteni, Moliëri, Volteri, Ruso, Metastazi, Gëte, Lesingu, Shileri, Uhlendi, Shatobriani, Lamartini, Alfred de Myse, Parini, Gjusti,




Monti, Manconi, Peliko, Porfiri, Edmondo de Amicis, Bajroni, Mistrali, Fokolo, Leopardi, Viktor Hygo, e disa të tjerë më pak të rëndësishëm, bashkëkohës të të sipërmendurëve. Emrat e shkrimtarëve evropianë, të përmendur më shpesh se të cituar në shkrimet e tyre, dëshmojnë se shkrimtarët e Rilindjes sonë Kombëtare më së shumti kanë çmuar, prandaj edhe kanë lexuar, letërsinë e këtyre epokave e periudhave në historinë e letërsisë evropiane: letërsinë antike greke, letërsinë romake, letërsinë e Renesansës italiane, Klasicizmin, Iluminizmin dhe Romantizmin. Mos do të thotë kjo se letërsia e shekujve të shkuar jo vetëm se ishte pjesë e kulturës së përgjithshme të shkrimtarëve të Rilindjes sonë Kombëtare, por edhe letërsia që ndikonte fort në prirjet e tyre, në ndjeshmëritë e tyre, prandaj edhe në strukturën e formacionit letrar që do të ndërtonin ata? Pa dyshim-po. Nuk mund të dyshohet se prej këtyre letërsive do të përzgjidheshin edhe veprat që do t'i

përkthehenin ata po t'i kishin kushtet që të merreshin edhe me veprimtari përkthimore.

LETËRSIA SHQIPE MIDIS DY LUFTËRAVE BOTËRORE DHE PËRKTHIMET

Është plotësisht e kuptueshme që në periudhën vijuese, pasromantike të letërsisë shqipe, të shtohet numri i përkthimeve në gjuhën shqipe, numri i shkrimtarëve të letërsive të ndryshme kombëtare që do t'i lexojnë dhe numri i shkrimtarëve që do t'i përmendin në shkrimet e tyre shkrimtarët tanë. Shqipëria është bërë e pavarur. Shumica e shkrimtarëve janë kthyer në atdhe. Është shtuar shumë numri i gazetave dhe i revistave në gjuhën shqipe. Janë themeluar shtëpi botuese, sidomos, në vitet e tridhjeta të shekullit njëzet. Zhvillohet jetë shumë gjallëruese mendore sidomos në kryeqytetin e shtetit të ri në Tiranë. Ide të reja dhe rryma mendore depertojnë në publicistikën shqiptare gjithnjë e më të zhvilluar. Ballafaqohen mendësi të kundërta, të djathta dhe të majta, që nxisin shkrimtarët dhe publicistët për leximin apo, madje, për përkthimin e veprave në të cilat janë trajtuar ato mendësi. Mund të vërehet se edhe në këtë periudhë të letërsisë shqipe para së gjithash lexohen dhe përkthehen pak a shumë letërsitë e epokave dhe periudhave që janë lexuar edhe prej shkrimtarëve të Rilindjes Kombëtare. Por, mund të vërehet se lexohen apo, madje, përkthehen edhe vepra të shkrimtarëve, filozofëve,



shkencëtarëve, publicistëve të

pjesës së dytë të shekullit nëntëmbëdhjetë apo të dhjetëvjetëshave të parë të shekullit njëzet: trajtesa dhe sprova të Frojdit, Dyrkemit, Nicës dhe jetëshkrime politike si jetëshkrimi i Ataturkut dhe jetëshkrimi i Benito Musolinit me parathënë të Ernest Koliqit! Përpos poezisë së poetëve antikë grekë e romakë, të Renesansës, të Klasicizmit e të Romantizmit, tani do të përkthehen edhe vjersha të Bodlerit, të Verlenit, të Xhoshue Karduçit, por edhe proza të Prosper Merimesë, Aleksandër Dymas, Selma Lagerlef, Mark Tvenit, Gy de Mopasanit, Luigi Pirandello, Oskar Vajldit, shkrimtarëve amerikane Perl Bak dhe Harriet Biçer Stou, Blasko Ibanezit, Ivan Turgenievit, Çehovit, Rabindranat Tagores, Emilio Salgarit, madje edhe të Maksim Gorkit. E të tjerëve. Megjithatë botohen vepra të shkrimtarëve evropianë që kanë jetuar në kohë më të afërme apo, madje, edhe në kohën midis dy luftërave botërore, bie në sy se, me përjashtim të poezisë së Bodlerit e Verlenit, nuk përkthehen vepra dhe, madje, nuk përmenden emra të shkrimtarëve modernë. Poezia e Rembos, Stefan Malarmesë, Pol Valerysë, Rainer Maria Rilkes, Tomas Stern Eliotit, Federiko Garsia Lorkës, Sent Xhon Persit, Pol Elyarit, Gjyom Apolinerit, Ramon Himenezit, Rafael Albertit dhe proza e Marsel Prustit, Franc Kafkës, Xhems Xhojsit dhe Virxhinia Vulfit mbesin plotësisht jashtë interesimeve letrare të shkrimtarëve tanë midis dy luftërash botërore. Pothuaj e kuptueshme. Zhvillimi shoqëror dhe kulturor, prandaj edhe zhvillimi letrar shqiptar nuk ishin bashkëkohësuar aq sa të pranoheshin lehtë e shpejtë idetë, temat, pamjet dhe ndjeshmëria që paraqiteshin në poezinë e ndjeshmëria që paraqiteshin në poezinë e prozën moderne. Mendësia dhe ndjeshmëria folklorike, tradicionale dhe romantike, ishin edhe më tej mendësi dhe ndjeshmëri mbi-otëruese në jetën kombëtare shqiptare. Por, megjithatë, veprat që përkthehen dhe veprat që lexohen në vitet ndërmjet dy luftërave botërore dhe, sidomos, gjatë Luftës së Dytë Botërore mund të supozohet se, pak a shumë, ndikojnë në shpejtimin e procesit të zhvillimit të letërsisë shqipe, duke ia afruar atë sadopak më shumë se letërsia e Rilindjes Kombëtare procesit të zhvillimit të letërsisë evropiane, domethënë procesit të zhvillimit të letërsisë të mëdha evropiane – franceze, italiane, angleze, gjermane dhe spanjolle.

LETËRSIA E SOTME DHE PËRKTHIMET

Pas Luftës së Dytë Botërore do të bëhen shumë përkthime në gjuhën shqipe. Veprimtaria përkthyes, tani, është veprimtari kulturore e organizuar dhe e institucionalizuar, që financohet prej institucioneve shtetërore. Në këtë kohë bëhen përkthime jo vetëm prej letërsive të mëdha evropiane – prej letërsisë antike greke e romake, prej letërsisë së Renesansës, prej letërsisë së Klasicizmit e të Illumizmit, prej Letërsisë së Romantizmit e të Realizmit, por edhe prej letërsive të popujve të vegjël evropianë dhe prej letërsive të kontinenteve të tjera. Meqenëse letërsisë botërore i kushtohet shumë kujdes në plan-programat e gjuhës e të letërsisë, shtëpitë botuese, të cilat janë të financuara prej shtetit, janë të obliguara t'i kushtojnë kujdes përkthimit dhe botimit të

Vetëm nga fundi i epokës së Rilindjes, në gazetën dhe revistat e pakta në gjuhën shqipe dhe në përmbledhjet e rilindësve botohen disa përkthime a përshtatje vjershësh, fabulash dhe prozash, kryesisht nga letërsia antike greke e romake, letërsia italiane dhe letërsia franceze. Botimi i ndonjë përkthimi si libër është tejet i rrallë.

veprave që janë në ato plan-programe. Si në Shqipërinë shtetërore, ashtu edhe në Kosovë, politika dhe ideologjia sunduese do të ndikojnë shumë, në Shqipëri pothuaj përcaktueshëm, në politikën e përkthimeve. Me kritere, që nuk mund të quhen se janë në kundërshtim me ideologjinë e doktrinën së realizmit socialist, në shtëpitë botuese në Shqipërinë shtetërore do të përzgjidhen veprat që do të përkthehen. Këto kritere nuk do të bëhen pengesë që të botohen vepra të shkrimtarëve të mëdhenj botërorë – të Eskilit, Sofokliut, Euripidit, Lukrecit, Ovidit, Virgilit, Dantes, Petrarkës, Ariostos, Shekspir, Servantis, Volterit, Rusoit, Rasinut, Kornejt, Molierit, Rablesë, Viktor Hygosë, Lamartinit, Shatobrianit, Pushkinut, Balzakut, Flo-

botojnë sa më shumë vepra letrare e shkencore të kombeve e të kombësitë të Jugosllavisë, por edhe të letërsive të vendeve të painkuadruara me të cilat Jugosllavia përbënte një si bllok politik. Në Kosovë do të botohen po thuaj të gjitha përkthimet e shkrimtarëve botërorë që ishin botuar në Shqipërinë shtetërore plus një numër përkthimesh që në shtëpitë botuese në Tiranë nuk ishin botuar. Por, letërsia moderne nuk do të jetë e përkthyer sa do të ishte e nevojshme as në Kosovë megjithatë arsyet e përkthimit të paktë të veprave moderne dhe avangarde në Kosovë nuk ishin ato arsyet që në Shqipëri e pengonin plotësisht përkthimin dhe botimin e tyre. Arsyet këtu ishin të tjera. E para, mjetet e lejuara prej institucioneve shtetërore për veprimtari

Akademik Qosja analizon ndikimin që ka përkthimi i letërsisë botërore në letërsinë shqipe përmes historishkrimit të përkthyesve që nga periudha e Letërsisë së vjetër, Rilindjes dhe shekullit XX

berit, Mopasanit, Emil Zolas, Tolstojt, Turgenievit, Gogolit, Gëtes, Shilerit, Carls Dikensit, Teodor Drajzerit e shumë e shumë të tjerëve. Përkthyes të tyre do të jenë poetë, prozatorë, publicistë e gjuhëtarë të njohur, të shkolluar në botën e huaj, kryesisht, në Itali, në Austri, në Francë, që njihnin për mrekulli jo vetëm gjuhën amëtare në të cilën bëheshin përkthimet, por edhe gjuhët prej të cilave i bënin përkthimet. Nuk është e çuditshme, prandaj, pse përkthimet e tyre do të mbesin shembull i përkthimit në historinë e përkthimeve në gjuhën shqipe deri sot. Kriteret e doktrinës së realizmit socialist, ndërkaq, do të bëhen pengesë që në shtëpitë botuese në Shqipërinë shtetërore të përkthehet letërsia moderne. Përkthimi i veprave të kësaj letërsie pengohet për shkak politik, ideologjik dhe si, thuaj, pedagogjik. Në të vërtetë ajo zhvlerësohet ideologjikisht dhe goja teorikisht si letërsi dekadente, e sunduar prej subjektivizmit, racionalizmit, pesimizmit, psikologjizmit, kundërhumanizmit, formalizmit, në përgjithësi prej karakterit reaksionar! Veprat e Bodlerit, Marsel Prustit, Franc Kafkës, Xhems Xhojsit, Viljem Foknerit, Alber Kamysë, Zhan-Pol Sartrit, Alen Rob Grjjesë, Mishel Bytorit, Natali Sarotit, dhe shumë e shumë shkrimtarëve të tjerë bashkëkohorë, që quheshin modernistë, ishin të ndaluar jo vetëm prej përkthimit, por edhe prej leximit. Ato nuk mund të importoheshin dhe ato po të gjendeshin në biblioteka, nuk mund t'u jepeshin lexuesve! Në Kosovë, realizmi socialist nuk ishte doktrinë sunduese në krijimtarinë artistike dhe shkencore, por edhe në Kosovë politika zyrtare, kur më pak e kur më shumë, ndikonte në politikën e përkthimeve të shtëpive botuese. Prej tyre kërkohet që të

përkthyes në masë të madhe do të shpenzohen prej përkthimit dhe botimit e veprave nga letërsia e kombeve e të kombësitë të Jugosllavisë dhe, e dyta, letërsia moderne në kishte e njohur mirë as në Kosovë. Përpos prej republikave të Jugosllavisë, në Kosovë institucionalist nuk importoheshin libra, gazeta e revista prej shteteve të tjera, përpos, me një sërë kufizimesh, prej Shqipërisë. Megjithatë kjo letërsi nuk ishte as e përkthyer sa do të duhej dhe as e njohur mirë në rrethet krijuese, sot mund të flasim për një ndikim të letërsisë moderne në letërsinë shqipe në Kosovë, në mënyrë të veçantë në poezinë shqipe në Kosovë. Dhe, ky ndikim i letërsisë moderne në letërsinë shqipe në Kosovë do të vijë përmes letërsive kombëtare, para së gjithash serbe, kroate dhe boshnjake, në të cilat ishte i fortë ndikimi i letërsisë moderne, dhe avangarde, evropiane. Në sajë të këtij ndikimi të drejtpërdrejtë dhe të ndërmjetuar të letërsisë moderne evropiane në letërsinë shqipe në Kosovë, sidomos, pas viteve të '70 të shekullit të kaluar, shpejtohet procesi i zhvillimit të letërsisë shqipe, sillen në të rryma, stile dhe teknika të reja krijuese, që më pak e më shumë e përshpejtojnë procesin e zhvillimit dhe të europizimit të saj.

LETËRSIA SHQIPE PAS RËNIES SË KOMUNIZMIT DHE PËRKTHIMET

Pas rënies së komunizmit në Shqipërinë shtetërore, në Kosovë do të Maqedoni shtohet shumë numri i shtëpive botuese. Shtohet numri i gazetave dhe i revistave. Shtohet numri i radiove dhe i televizioneve. Marrëveshja politike, letrare, artistike dhe shkencore me botën është e liruar prej pengesave, që i viheshin në kohën e komunizmit. Është e kuptueshme, prandaj, pse në këtë kohë shtohet jashtëzakonisht shumë numri i përkthimeve nga letërsitë evropiane, nga letërsia amerikane dhe nga letërsitë latinoamerikane. Ribotohen përkthimet e veprave klasike të letërsisë botërore dhe bëhen përkthime të reja të traditës letrare evropiane dhe, pak a shumë, amerikane. Letërsia moderne, ndërkaq, nuk do të jetë më shumë e përkthyer se sa në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar në Kosovë. Me përkthimin e disa prozave të Kafkës, të Xhojsit, të Virxhinia Vulfit, të Samuel Beketit, të Markesit, të Gynter Grasit, të Umberto Ekos, të Natali Sarotit e Mishel Bytorit nuk mund të thuhet se plotësisht nevojia letrare për njohjen e letërsisë moderne në jetën tonë mendore. Arsyet kryesore pse shtëpitë tonë botuese sadopak ngurrojnë për botimin e veprave moderne dhe, tani, postmoderne, është interesimi edhe më tej i vogël i lexuesve për këta tipa të letërsisë. Pavarësisht pse komercializmi në masë të madhe po ndikon në politikën tonë botuese, dhe, rrjedhimisht, në politikën e përkthimeve, mund të thuhet se roli i përkthimeve dhe i marrëveshjeve të papenguar me botën sot është më i madh dhe më i gjithanshëm se kurrë në historinë e letërsisë shqipe. Në sajë të këtyre përkthimeve dhe në sajë të këtyre marrëveshjeve po rritet përvoja jonë krijuese, po qarkullojnë ide të reja në jetën tonë mendore, po përvetësohen prijet, stile, teknika të reja krijuese, po përshpejtohet ritmi i zhvillimit të letërsisë shqipe dhe i artit shqiptar në përgjithësi. Bota është gjithnjë e më e pranishme në jetën tonë shpirtërore. Por, cili do të jetë fati i Vatërës sonë në Botën e sotme mbetet për t'u parë.

NË | STUDIO



pjeter logoreci

NË FOTO:
(majtas)
Skulptori
Destan Gashi
në Atelien e tij
(djathtas)
Legjenda
e Rozafës
e gdhendur
në gur nga
Destan Gashi



pjeter logoreci



DESTAN GASHI

Guri i çmueshëm i Kosovës

Profili i një skulptori kosovar në Vjenë... nga ditët e fëmijërisë në Ziqisht të Rahovecit, ku krijonte figurina të mrekullueshme me baltë deri tek ekspozitat, vlerësimet dhe përhapja e veprave të tij nga Amerika, Italia, Austria, Gjermania, Zvicra, Spania, Lichtensteini, Belgjika, Hollande...

NGA PJETER LOGORECI

Më Destan Gashin u njohëm në një galeri arti në Vjenë, ku të dy u gjendëm për të shijuar punimet e piktorit kosovar Gazmend Freitag. Destanin e kisha parë një herë, në verë, në koloninë e artit në Velipojë të cilën drejton mjeshtri shkodran, skulptori Skënder Kraja. Pas njohjes e bisedave të para, ai më ftoi që të vizitoja studion e tij, e cila gjendet (në Himberg) në periferi të Vjenës. Sapo ishte mbyllur një ekspozitë e tij në Vjenë të cilën nuk pata mundësi ta shoh, kështu që e prita me shumë kënaqësi ftesën pasi do të shihja veprat, të gjithë punën e tij.

Është shumë interesante të kundrohësh një skulptor gjatë procesit të punës në atelie, prandaj mora me vete edhe aparatën fotografikë që të mund të fiksoj mbresat e mija. Sapo hyra në atelienë e tij u përballa së pari me flamurin kombëtar që varej në krahun e një "burri - gurë" shtatlartë që të krijonte përshlypjen se sapo kërkonte ta ngrinte diku lart... Pas pesë minutash u ndjeva lirshëm, por edhe në një ambient të njohur e të këndshëm për mua, mbasi shumë objekte më "flasin" shqip... Në



vendin ku isha ulur për të shijuar kafën që më ofroi mikpritësi, isha i rrethuar nga legjenda e figura që i njihja që fëmijë...

Gjëja që më çudit shumë ishte se përpara gurëve - figura që po punoheshin nuk kishte asnjë model të gjalle, vizatim apo maket, pasi Destani punonte direkt me sy të lirë në gurë. Destani është ndër

të paktët artistë bashkohorë që ushtrojnë në Vjenë artin e vjetër të skulpturës. Për të shuar kuriozitetin tim, ai filloi të më tregojë me pasion origjinën e karakteristikave të gurëve të tij... ja mermeri i bardhë me vjen nga Carrara e Italisë... por unë nuk po dëgjoja mbasi instinktivisht isha afruar pranë fëmijës - gurë që pi qumështin e



pjeter logoreci

NË FOTO:
(Majtas)Gruja nga Hasi, mermer nga Bummerner, 2010
(djathtas) Gjergj Kastrioti - Skenderbeu, gurë zalli, 2009

giut të Rozafës....Po po atje ku dhemb dhëmbi vete gjuha më përmendi ai nga kujtimet e malli që më kishte mbërthyer.... po ..Shkodra (kështu më quan ai mua - Shkodra)...ky është guri i bardhë i Carrarës që ngjanë me gurët e lagur nga qumështi i bardhë i nënës Rozafa....

Vazhduam të bisedonim rreth

jetës së tij private dhe artistike. Ai më tregoi se vinte nga një familje e varfër nga Zoqishti / Rahoveci i Kosovës ku kishte mbaruar shkollën fillore duke treguar shenjat të veçanta të talentit të tij në krijimin e figurave të vogla nga balta amtare, të cilat mësuesit ja pëlqenin shumë. Më vonë pas shumë vështirësish ekonomike dhe familjare kishte frekuentuar shkollën e mesme të artit figurativ në Pejë. Në shpirtin rebel të Destanit digjej dëshira për të prekur me dorë rrugët e artit. Kështu me punë këmbëngulëse arrin të fitojë konkursin e pranimit në Akademinë Mbretërore të Arteve të Bukura në Bruksel e cila drejtohej nga Profesoresha e njohur Vanservenbergen, ku me 1978 diplomohet për pikturë. Më pas kthehet në Kosovë ku punon për dy vjet si mësues vizatimi i shkollës Zoqishtë. Gjatë kohës në fshat, i ringjallet dëshira e vjetër për skulpturën dhe vendosë të plotësojë njohuritë e tija në fakultetin e skulpturës të Akademisë së Arteve të Bukura të Brukselit që drejtohej nga Profesi Martin Guyaux, ku me 1985 merr titullin e diplomën e Skulptorit profesionist. Më pas vendoset në Vjenë, pasi në vitin 1981 kishte njohur shoqen e tij të jetës, Barbarën, vajzën nga Vjena.

Pas viteve me impenjim të plotë për formimin e tij, fillon periudha e krijimtarisë ku pat prodhimtari të bollshme. Në punën e tij ai frymëzohet me tema nga folklori shqiptar, por edhe bukuria e femrës prek shpirtin e tij artistik. Figurat e femrës të skalitura në gurë zënë një vend të madh në krijimtarinë e tij. Kushdo që përballtet me punën e tij, kupton botën e madhe shpirtërore të Destanit, temperamentin rebel e po ashtu shpirtin e butë të tij. Figurat si Rozafa, Dy Vajzat, Nëna me Bin-



pieter logoreci

Skulptori Destan Gashi në punë e sipër në atelin e tij

jaket, Aurora, Vajza Afrikane, Vajza në Plazh, Nymphe, po ti kundrosh, të mbushin me dhembshuri, por edhe me dashuri njerëzore. Nga energjia e eleganca e fantazisë së Destanit, janë krijuar figura që "flasin" vetë si: Kërcimtarja, Balancë, Lisa, Kërmilli. Artisti Gashi në të shumtën e rasteve viziton personalisht guroret (minierat e gurit) nga ku vendosë për bllokun e gurit në masën e ngjyrën e parashikuar. Nganjëherë, aty në minierë frymëzohet dhe i lindin idetë e reja për krijesat të reja artistike. Zakonisht, për punët e tij ai përdorë materiale guri nga "Sölker, Krastaler, Mermer

në atë mermer. Destan Gashi ka punime të cilat gjenden në të gjithë anët e botës që nga Amerika, Italia, Austria, Gjermania, Zvicra, Spania, Lichtensteini, Belgjika, Holanda...të cilat janë të vendosura në sheshet kryesore të qyteteve (e që janë pronë e shtetit - Bashkisë) apo i përkasin ndonjë koleksionisti privat. Ai është nderuar për punën e krijimit e tija me shumë çmime ndërkombëtare. Qysh student ai u nderua nga Bashkia e Bruselut për punimin në gurë të Dona Barbantia, e cila është e vendosur në qendër të qytetit. Bustin e Gjergj Kastriotit – Skënderbeut, një punë

krejt e veçantë nga sa ne jemi mësuar ta shohim në Shqipëri, ai e ka të shitur tek një koleksionist privat në Dibër.

Gjatë karrierës së tij artistike Destani së bashku me Barbaran, gruan e tij austriake, kanë organizuar shumë ekspozita, në Austri e në shumë vende të Europës. Suksesi i tyre ka qenë i padiskutueshëm, gjë që është pasqyruar gjerësisht në shtypin e kohës. Skulptori Destan Gashi është një figurë e njohur edhe për pushuesit dhe turistët në Itali dhe Austri, nga figurat e tij të punuara në rërë gjate bregdetit Italian, apo në figurat e krijuara në dëborë në bjeshkët e Austrisë. Në muajin e ardhshëm në Vjenë do të hapet ekspozita e verës ku marrin pjesë shumë artistë nga Austria e nder to edhe skulptori ynë Destan Gashi.



Figurë në rërë, Jesolo 2005

nga Wachau, Arlburger, Gummerner, Mermer nga Südtirol, gurë Italian nga Carrara, gurë Brasilian apo të Salzburgut". Kombinimi i ngjyrës dhe linjave (strukturës) të gurit ka ndikimin e vet në fantazinë dhe kreativitetin e Destanit. Më tërhoqi vëmendjen punimi Gruaja e Hasit ku struktura dhe ngjyrat e gurit ishin të larmishme e të ngjashme me veshjen kombëtare të asaj zone, pra gjetja ishte e pësosur si vetë bukuria e gruas së gdhendur

RIKTHIMI | I VEPRËS


Faik Ballanca, "Nomeja e largët" një roman ndryshe

Romani i vetëm i autorit ribotohet i plotë. Shtohen pjesët që u censuruan në kohën e diktaturës. Mesazhet e veprës

SPIRO GJONI

Pasi je njohur me tregimet, novelat dhe reportazhet e Faik Ballancës, natyrisht që ke krijuar një opinion të përgjithshëm për këtë shkrimtar dhe një vlerësim të caktuar, si për të, ashtu dhe për krijimtarinë e tij. Por a është kjo e mjaftueshme dhe e plotë? Sigurisht që jo kur dihet që Faiku ka shkruar dhe një roman. Në çmasë kjo veprë i shton vlerat e krijimtarisë letrare të këtij autori, ç'vend zë ajo në kuadrin e gjithë veprës së Ballancës, cila është e reja që shkrimtari sjell nëpërmjet këtij romani, krahasuar me krijimtarinë e tij por, dhe më gjërë, me krijimtarinë letrare të kohës kur jetoi e krijoi: këto dhe shumë pyetje të tjera prej kohësh kanë ngacmuar e tërhoqur vëmendjen tonë, duke na çuar drejt përpjekjeve për t'u dhënë një përgjigje të argumentuar, në kuadër të qasjes dhe vlerësimit tërësor të veprës së këtij shkrimtari. Ashtu si autori edhe vepra e tij e, në rastin konkret, romani "Nomeja e largët" nuk janë të panjohur për lexuesin tonë, i cili tashmë e njeh dhe Ballancën, peripecitë dhe kuadrin e tij tragjik, por dhe tregimet e novelën që, më pas çoi në daljen në dritë të romanit, me atë mori ngjarjesh e personazhesh, të njohur e anonimë, me realitete historike e bashkëkohore dhe me të "njohurin" e "të panjohurin" Bendo. Megjithatë është shumë pak për një roman të tillë, të mjaftohesh me përcaktimet e mësipërme. Është shumë pak pasi edhe me një lexim të vetëm, bindesh se ke të bësh me një roman ndryshe. Është i tillë jo në kuadër të krijimtarisë së Ballancës, sepse ai nuk shkroi romane të tjerë me të cilët të krahasohej, por dhe në kuadrin e krijimtarisë në plan më të gjerë. Nuk gabojmë nëse romanin do ta vlerësonim si një risi origjinale në fushën e prozës së gjatë, jo vetëm për periudhën kur u shkrua. Argumentimi tërësor i këtij përfundimi, sigurisht që nuk është objekt i shkrimit tonë. Megjithatë të qenit risi ose roman ndryshe ne do ta mbështesim në tri elemente:

1. Autori në romanin e tij na ofron një material faktik jetësor që, me pak përjashtime, është në funksion të plotë të idesë që ai kërkoi t'i transmetojë lexuesit



Faik Ballanca

2. Nëpërmjet një përzgjedhjeje të përcaktuar saktë e qartë të materialit jetësor, nga dy periudha kohore të ndryshme dhe ndërthurjes së tyre në mënyrë origjinale, ai ia ka arritur të realizojë me sukses një kohezion ideor mes së shkruarës e të tashmës. Në procesin përzgjedhës autori nuk mund të mos që i vëmendshëm e i kujdesshëm ndaj personazheve si bartës e shprehës të karaktereve të caktuar, por dhe në funksion të plotë me synimet ideartistike të romanit. Në këtë pikë do të mjaftoheshim duke sjellë në vëmendjen e lexuesit personazhin e Bendor, i cili përfaqëson një karakter jo vetëm origjinal, por edhe unik në letrat shqipe.

Mund të vendosim dhe shumë fakte e elemente të tjera, si në pla-

nin e përbajtjes, ashtu dhe atë të formës që na e përforcojmë përherë e më shumë bindjen se kemi të bëjmë me një roman ndryshe. E tillë është struktura kompozicionale e tij (me alternim kapitujsh klasikë dhe historish anonimë) ndërthurja e të tashmes me të shkuarën (jo përmes digresioneve), mëvetësia, por dhe korrelacioni i ngjarjeve, futja si një element tepër rëndësishëm kompozicional i një personazhi të vogël në moshë, por "të madh" në detyra e veprime, "çelës" i zbrërthimit e kuptimit të veprës. Sigurisht, të gjitha këto, por edhe të tjera të pranishme në veprë janë fakte domethënëse që e mbështesin mendimin tonë. Por, në këtë kuadër, kurrsesi nuk mund të lemë pa përmendur faktorin kryesor, atë që i dha jetë e vlera të veçanta artistike ngjarjeve që pa, dëgjoi e jetoi me banorë dhe blegtorëve të atij fshati të krahinës së Rrëzës në rrethin e Tepelenës, shkrimtarit Faik Ballanca. Ishte Faiku që me talentin, artin dhe punën e tij nxori në dritë një veprë tërë mbresëlënëse me mesazhe të fuqishme për të djeshmen, të sotmen e të ardhmen, por dhe me cilësi të spikatura artistike. Ishte Faik Ballanca që për aq kohë sa shkroi e krijoi (dhe pse jeta e tij u ndërpre shumë shpejt) na dha vetëm art, pa rënë në asnjë rast "viktimë" e izmave e standardeve frenuese e shkatërruese të realizimit socialist. Ishte Faiku, që siç shpreh në një shkrim të tij shkrimtari Nasi Lera, "...kishte thënë që në tregimin e tij të parë diçka që nuk ishte thënë, diçka që përmbyste, trondiste dhe shkundte nga individualiteti i trajtën e pluhurosor të trajtimit uniform të një teme apo personazhi".

Faik Ballanca (1945-1977)

Lindi dhe vdiq në Tiranë në një familje intelektuale të Lardhur nga Dibra e Madhe. Pasi kreu gjimnazin dhe mbaroi Fakultetin Histori-Filologji (dega e gazetarisë), punoi gazetar e redaktor në gazetën "Zëri i Rinisë" dhe në revistën letrare "Nëntori" të LSHASH-së.

Që nga viti 1962 nisi të botonte tregimet e para dhe të përktente e të botonte prozë nga gjermanishtja, italishtja e frëngjishtja. Edhe pse e ndërpreu krijimtarinë letrare në moshë të re, F. Ballanca arriti të krijojte individualitetin e veçantë si shkrimtar i vërtetë i mirënjohur, në sajë të kulturës së gjerë, intuitës së hollë artistike dhe skrupulozitetit krijues.

TRADITA | VLERA

Emigrimi i arbëreshve të San Paolos për në Amerikë

Historia e Giacinto Blumetti, lindur në Sao Paolo Albanese në vitin 1930, i cili tregon se si u arsimua dhe perpjekjet për të mësuar zanatin e rrobaqepësit e mandej emigrimin drejt Amerikës...

ROSA BUCCOLO

Në vitin 1861 Italia gjendej akoma në kushte ekonomike, politike dhe sanitare shumë të këqija. Kjo është ajo që tregohet në komunën e vogël San Paolo Albanese që në atë vit jetonin 1430 banorë dhe në dekadën në vijim ka pasur një rënie prej 7.7% të popullsisë për shkak të emigrimit dhe epidemisë së kolerës.

Më pas shifra ulet deri në 23.2% në 1901 për shkak të epidemisë së fundit të lisë në 1870-71, duke prekur komunën e San Paolo Albanese që ccoi në numrin e banorëve në 836.

Në dekadat vijuese shënohet një tjetër rënie të lartë e popullsisë ku në vitet 1961-1971, popullsia shënoi një rënie prej 21%.

Këtë herë shkak ka qenë emigrimi në Gjermani, Francë, Zvicër dhe SHBA. Një fat që bashkoi shumë prej banorëve të San Paolos ku me kalimin e viteve u rikthyen

Përvoja

Në fillim ai punoi në një fabrikë këmishash. Me dollarët e kursyer ai hapi një rrobaqepsi të tijn për këmisha (dukej si një ëndërr) në një nga rrugët më të njohura të Nju Jorkut. Më pas ai u bashkua me vajzën dhe gruan të cilat e ndihmuan deri në vitin 1992, vit në të cilin familja Blumetti u kthye definitivisht në Itali.

popullarizuara në atë kohë ishte muratori apo rrobaqepsi.

I vetëdijshëm që smund të bënte punë të rënda, ai vendosi për të

mësuar artin e rrobaqepësisë!

Mësuesi i tij i parë ishte pikërisht një bashkatdhetar i tij Antonio Abitante i cili, në pak vite, i mësoi atij të gjitha truket e zanatit.

Kështu filloi të realizonte qepjet e tij të para por kërkesat ishin aq sporadike sa nuk përmbushnin nevojat e tij ekonomike.

Një ditë, deshi fati që ai të lexonte në një artikull gazete një njoftim për vende pune për rrobaqepës në një fabrikë të njohur amerikane.

Ishin vitet në të cilat ishte e zakonshme të flitej për Amerikën si një parajsë dhe pak ditë më vonë, ai u nis me një anije me destinacion Amerikën.

Ishite viti 1960, dhe vështirësitë nuk mungonin. Aty ai gjeti një gjuhë dhe një kulturë të ndryshme dhe të largët nga vendi i tij por kuptoi menjëherë se vendi që e priti i ofroi të drejta dhe detyrime



Giacinto Blumetti

Në dekadat vijuese shënohet një tjetër rënie të lartë e popullsisë ku në vitet 1961-1971, popullsia shënoi një rënie prej 21%

dhe se sakrificat e tij do të ishin të frytshme për të ardhmen e tij dhe familjes së tij.

Në fillim ai punoi në një fabrikë këmishash. Me dollarët e kursyer ai hapi një rrobaqepsi të tijn për këmisha (dukej si një ëndërr) në

një nga rrugët më të njohura të Nju Jorkut.

Më pas ai u bashkua me vajzën dhe gruan të cilat e ndihmuan deri në vitin 1992, vit në të cilin familja Blumetti u kthye definitivisht në Itali.

Aljbëreshët e Ahën Paljit e e dyta migracjunë: Merka

Në 1961 në "Taljet ish një mizerje e fort e ashtu edhe Shën Palj: nd'atë mot kish 1430 njeriz e, dhjetë viet pas, buar 7,7 % i popullacjunës me epideminë kolerje e 1865/67, e njëra -23% në të jetrën e 1870/71 pas të ciljës, në 1901, katundi u vokrhu me 836 kishterë. Në vitrat që shkuan situacjuna nëk u ndrua shumë njera në 1961/71 kur buar gjindë për 21%; po, këtë herë, më se pesta ftesi migracjuna në Merket e në Xhermanjet. Shumë shënpaljtë van e ata që u pruarin na rrefejtin që pësuan e si e shkuan.

Një ndër këta është Jaçindi Marjes Jaçindit (Giacinto Blumetti): Ai ljeu Shën Palj në 1930 e na tha se pas që bëri skollën njëra

Në vitrat që shkuan situacjuna nëk u ndrua shumë njera në 1961/71 kur buar gjindë për 21%; po, këtë herë, më se pesta ftesi migracjuna në Merket e në Xhermanjet. Shumë shënpaljtë van e ata që u pruarin na rrefejtin që pësuan e si e shkuan.

14 vjeçe për të kish bukën pat të zgjidh të xëj një mistier. Ahiena të shumë bëshshin muratur ose sart

e mbazi se ai s'dihej trim i fort zg-jodh artën e të qepurit: sartin. Të parin mjeshtër që pat klje Ndoni Sirenës (Antonio Abitante) i cilji tek pak mot ia mësoj gjithë truket e mëstjerit. Ashtu tu fil e bënej të parët ljiwere po fëtiga mangonej e s'dij si kish të bënej. Një ditë diuvasi tek nje xhurnal se një fabrike amerikane kërkonej artixhane e të qepurit. Merka i dukej të gjithëve si parrajsi! E ashtu edhe Jaçindit që u nis e vate Napulj bëri provën e i thanë "OK". U pruar në katund i skutist pse nëk kish kapirtur se që vinej me thënë "OK" e ia pyeti mjeshterit tij që i tha se ish gjithë në rregull e të vej të prapararnej valixhën. Pas disa ditë Jaçindi u nis n'atër herë për Napuljin e muar navën për Merken. Ish në

1960 e kur arrivoj, së pari, jeta ju duk e ljiçë: atje gjet një gjuhë e një kulturë ndryshe po atë që kapirti tundu klje se ai vend kish rispiet për njërit të drejtë e s'e buar fare vethenin për fëmijën, për të biljën. Zu fil e shërbeu tek një fabrike ku bëjin vetëm këmisha e mënga ljiwereshë me makinare: "më kishin vënë e bënja sulu mënga" thot Jaçindi e ai nëk ndihej pljot tek mistjeri tij pse ai ljiweret i bënej që në kryet njera në fund. Sa mono bëri çika turres, hapi vet një këmishëri tek një udhë më të bukura e Novajorkës i thirri edhe të shoqes e të biljës që e ndihti njera në 1992, kur për motive familjare pati të prishrin në "Taljet.

Pietro Abitante

Edhe atje ku vota juaj është e fshehur, ju siguroj që tran sparcenë e bëjnë të tjerët. Siguri sht duke e modifikuar Edhe aoj që tran sparcenë e bëjnë të tjerët. Siguri sht duk

në vendin e tyre duke bërë të mundur që në të bëhemi të vetëdijshëm për përvojën e tyre të emigrantit.

Një histori e tillë i takon z Giacinto Blumetti, lindur në Sao Paolo Albanese në vitin 1930, i cili tregon se u arsimua deri në moshën 14 vjeç, dhe për arsye të vështirësive ekonomike, ai u detyrua të gjente një punë.

Zgjedhja mes dy zanateve më të